

Nr. \_\_\_\_ Prot

Data \_\_. \_\_. 2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Blerje paisje dhe materiale elektrike

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Materiale elektrike 31681410-0

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

5.000.000 (pesemilion) lekë pa T.V.SH.

I mbajtur sot me date 30.05.2024 ne Autoritetin Kontraktor Bashkia Finiq, ne mbledhjen e njesise se prokurimit te perbere prej Florida Lula, Klejli Muharremi , dhe Fotaq Muça ngritur sipas Urdhërit te Prokurimit Nr.13, datë 23.05.2024 per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te veçanta te pranimit te procedures se prokurimit me objekt: “Blerje paisje dhe material elektrike”, prokurim elektronik “Procedure e hapur e thjeshtuar”, me fond limit 5.000.000 (pesemilion) leke pa përfshirë vleftën e TVSH-së, sipas perlllogaritjeve te kryera, referuar vleres se projektit te zbatimit.

Është zgjedhur kjo procedurë në mbështetje të Nenit 42 të LPP-së.

Hartimi i specifikimeve teknike te ketij objekti eshte kryer nga Specilistet e Drejtorise se Planifikimit te Territorit te Bashkise Finiq.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Finiq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.1.1** Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c", të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.3.** Vertetimi të lëshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara për vitin 2023.

Për plotësimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit).

*Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që kontratat e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

**2.3.2** Licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e furnizimit të mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

**2.3.3** Operatorët ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

Mostra për secilin artikull të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor para datës së hapjes së ofertave; dhe/ose

Fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deshmojnë se i plotesojnë specifikimet për mallrat e percaktuara në listën e autoritetit Kontraktor, e për këtë ata duhet të paraqesin mostrat për secilin mall të kërkuar, fotografi apo kataloge, si dhe deshmi për rezultatet e testimeve zyrtare të leshuara nga institucione të autorizuar.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera noteriale 1 (një) mjet transporti mallrash me kapacitet jo më pak se 1,5 (një presje pese) Ton.

*Per plotesimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari përmbledhës i vetedeklarimit). Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Në zbatim të kësaj ndryshimeve ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:*

Për mjetin në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit.

Për mjetin e marre me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit. Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion një mjet transporti me kapacitet mbajtes jo më pak se 1,5 ton, i nevojshëm për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Sa me sipër Njësia e Prokurimit

**vendosi:**

1. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Blerje paisje dhe material elektrike”
2. Miratimin e kriertereve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje paisje dhe material elektrike.
3. Në zbatim të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021, neni 45, pika 2, Kriter vlerësues të jete:  
**- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim**  
Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 18.06.2024, Ora 09<sup>00</sup>

Në zbatim të manualit të miratuar me Udhezimin nr.7, datë 30.07.2021 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”, të Agjencisë së Prokurimit Publik, Njësia e Prokurimit autorizon Znj. Florida Lula për të kryer veprimet në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

**Njësia e Prokurimit**

Florida LULA

Klejli MUHARREMI

Fotaq MUÇA